



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

V E N D I M

NR. 3, DATË 10 /04 /2025

PËR

**MIRATIMIN E STATUSIT “INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK
PROCEDURË E ASISTUAR” PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT “RADISSON
INDIVIDUALS PREMIUM BORSH”, ME SUBJEKT “GRAND HOTEL BORSH”
SHPK NUIS M01414027F**

Në zbatim të neneve 8, 9, 17, 18, 21 dhe 29 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut II, pika 8 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA),

VLERËSOI:

- Projekti i investimit është në përputhje me kriteret e parashikuara në nenin 8 të Ligjit Nr. 55/2015, i ndryshuar.
- Projekti i investimit propozohet të realizohet nga subjekti aplikues “Grand Hotel Borsh” SHPK NUIS M01414027F.
- Projekti përfshin të gjithë komponentët që i përkasin sektorit së turizmit si hotel brand me 5 yje, i cili do të përfshijë 240 dhoma dhe 4 vila private, i cili do të ofrojë gjithashtu një gamë të gjerë shërbimesh si beach bar, restorante, pishina, SPA, qendër sportive, park ujor, palestër, mini teatër etj.
- Vlera e investimit të projektit të investimit “RADISSON INDIVIDUALS PREMIUM BORSH” i plotëson kriteret e parashikuara nga legjislacioni për investimet strategjike dhe parashikohet të jetë mbi 27.6 (njëzetë e shtatë pike gjashtë) milionë Euro.
- Sipërfaqe totale e projektit është 18.500 m² (1.85 ha) në ZK 1253, në fshatin Borsh, Bashkia Himarë, e cila është në pronësi private të ortakëve të subjektit aplikues

Grand Hotel Borsh sh.p.k.

- Projekti i investimit i plotëson kriteret e punësimit të kërkuara nga legjislacioni për investimet strategjike dhe parashikon të punësojë 255 (dyqind e pesëdhjetë e pesë) punonjës.
- Projekti është pajisur me leje ndërtimi miratuar nga kryetari i Bashkisë Himarë me vendimin Nr. 166, Prot. 4720/2, datë 15.12.2022, “Strukturë 1-5 Kate me 1 kat nëntokë, me funksion hoteleri”, në ZK 1253, Borsh, Himarë.
- Shoqëria aplikuese Grand Hotel Borsh sh.p.k, është pajisur me statusin e veçantë “Investitor në strukturë akomoduese me 5 yje, status special”, miratuar me VKM-në nr. 405 datë 19.06.2024 dhe në vijim ka nënshkruar marrëveshjen e zhvillimit me Ministrinë e Turizmit nr. 4112/5 prot., datë 19.07.2024.
- Projekti i propozuar ka nënshkruar marrëveshje me brandin ndërkombëtar Radisson Hospitality Belgium SRL.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Miratimin e Statusit “Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Asistuar” për projektin e investimit “Radisson Individuals Premium Borsh”, me subjekt “Grand Hotel Borsh” sh.p.k NUIS M01414027F.
2. Projekti i investimit strategjik “Radisson Individuals Premium Borsh” zhvillohet nga subjekti “Grand Hotel Borsh” sh.p.k. M01414027F.
3. Projekti i investimit strategjik parashikon realizimin e investimit mbi 27.6 (njëzetë e shtatë pikë gjashtë) milionë Euro.
4. Projekti zhvillohet në fshatin Borsh, Bashkia Himarë me sipërfaqe totale në pronësi private të ortakëve të subjektit aplikues Grand Hotel Borsh sh.p.k.
5. Statusi “Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Asistuar” i jepet projektit të investimit “Radisson Individuals Premium Borsh” për një periudhë 3 (tre) vjeçare.
6. Në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike, përkatësisht neni 21 dhe neni 29 i Ligjit Nr.55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”,

i ndryshuar, masat mbështetëse që i jepen projektit të investimit strategjik janë si më poshtë:

- a) Miratohet masa mbështetëse e kryerjes së procedurave me prioritet dhe brenda afateve të përshpejtuara, në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike;
 - b) Miratohet masa mbështetëse e lejimit të përdorimit të brigjeve të detit si dhe zonën përkatëse të plazhit.
7. Në zbatim të nenit 29 të Ligjit Nr.55/2015, i ndryshuar, miratohet në parim masa mbështetëse e lejimit të përdorimit të brigjeve të detit si dhe zonën përkatëse të plazhit për parcelën Kodi: HI-215/5 e tipologjisë “e menaxhuar”, si dhe për parcelën Kodi: HI-216 e tipologjisë “e menaxhuar”, sipas koordinatave të konfirmuara nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Aneks 1 i këtij vendimi, me një afat 30 (tridhjetë) vjeçar. Miratimi përfundimtar dhe koordinatat respektive që i përkasin parcelave të plazhit të kërkuara nga subjekti, do të përcaktohen në marrëveshjen përkatëse që do të lidhet ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe Investitorit. Tarifa që do të aplikohet mbi këtë marrëveshje përcaktohet me Vendim të Këshillit Bashkiak. Në çdo rast, gëzimi i përdorimit të bregut të detit si stacion plazhi fillon pas vënies në funksion të strukturës akomoduese turistike.
8. Mënyrat, procedurat, afatet dhe organet zbatuese për ofrimin e masave mbështetëse përcaktohen edhe në planin e veprimit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
9. Në rast se përgjatë përgatitjeve, zhvillimit dhe zbatimit të projektit investues strategjik “Radisson Individuals Premium Borsh” konstatohen dhe vërtetohen se në projektin investues ka të dhëna të pavërteta apo ndryshim të të dhënave të dala rishtazi, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për përfshirjen e këtij projekti në procedurën e asistuar/e veçantë, Komiteti i Investimeve Strategjike ka të drejtë të vendosë për anulimin e vendimit për dhënien e statusit strategjik.
10. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike, në asnjë rast nuk do të konsiderohet investim, qoftë sipas kuadrit vendas ashtu edhe atij ndërkombëtar, në fuqi në Republikën e Shqipërisë, duke qenë se miraton në parim realizimin e një projekti investimi, materializimi i të cilit do të bazohet në përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve që parashikojnë legjislacionet sektoriale në fuqi.
11. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i njoftohet investitorit.

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

BLENDI GONXHJA

MINISTËR I FINANCAVE

PETRIT MALAJ

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

ANILA DENAJ

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS

LAURA PLAKU (SARO)

PLANI I VEPRIMIT

**PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT STRATEGJIK “RADISSON INDIVIDUALS
PREMIUM BORSH”, ME SUBJEKT “GRAND HOTEL BORSH” SHPK NUIS
M01414027F**

1. Përmbajtja e planit të veprimit

Plani i veprimit për realizimin e një projekti strategjik, përcakton:

- Procedurat lehtësuese që do të zbatohen për realizimin e investimit strategjik dhe afatet e përshpejtuar brenda të cilave duhet të kryhen;
- Shërbimet ndihmëse që do të ofrohen ndaj projektit strategjik;
- Masat mbështetëse që do të nevojiten për mbështetjen e investimit strategjik;
- Organet përgjegjëse për zbatimin e investimit strategjik;
- Detyrat përkatëse për secilin organ të përfshirë në realizimin e investimit strategjik;
- Programin e punës për realizimin e investimit strategjik të detajuar në faza;

2. Zbatimi i planit të veprimit

Plani i veprimit monitorohet nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, e cila koordinon veprimtarinë me organet e tjera shtetërore dhe me investitorin.

Autoritetet publike, të përfshira në mënyrë direkte apo indirekte në realizimin e një investimi strategjik, kanë detyrimin ligjor në lidhje me trajtimin me prioritet të procedurave dhe brenda afateve të përshpejtuar. Këto organe kanë detyrimin ligjor që të bashkëpunojnë dhe t’i japin Agjencisë, sqarime, informacione, lejet, licencat, autorizimet, mendimet dhe dokumentet e nevojshme në lidhje me përgatitjen, zbatimin dhe realizimin e një projekti investues strategjik.

**3. Informacione të përgjithshme mbi Planin e Veprimit të projektit “Radisson
Individuals Premium Borsh”**

Ky plan veprimi për realizimin e këtij projekti investimi, përcakton masat, procedurat dhe afatet, në lidhje me shërbimet dhe lehtësimin e procedurave për hartimin dhe zbatimin e projektit investues strategjik, në të cilin përcaktohen angazhime, detyra dhe afate konkrete për institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore, për të gjitha fazat e realizimit dhe zbatimit të projektit.

Plani i veprimit, u hartua nga grupi operacional i krijuar pranë Agjencisë Shqiptare të

Zhvillimit të Investimeve, bazuar në karakteristikat e projektit të propozuar. Për këtë qëllim, propozuesi i investimit strategjik, ka listuar dhe treguar qartësisht në momentin e paraqitjes së aplikimit, procedurat, shërbimet dhe masat mbështetëse konkrete, të cilat kërkon të përfitojë nga shteti shqiptar, për realizimin e investimit.

Plani i veprimit u hartua pasi propozimi i paraqitur mbi investimin strategjik të projektit “Radisson Individuals Premium Borsh” është vlerësuar paraprakisht dhe ka një rekomandim pozitiv të Komitetit të Investimeve Strategjike në lidhje me miratimin e tij. Autoriteti përgjegjës për miratimin e planit të veprimit për çdo projekt strategjik të miratuar është Komiteti i Investimeve Strategjike.

4. Hapat procedurale

Propozimi nga investitori:

Investitori "Grand Hotel Borsh" sh.p.k., kur paraqiti projektin e investimit tek AIDA, në përputhje me legjislacionin, ka specifikuar edhe listën e procedurave, shërbimeve dhe masat mbështetëse që kërkon për realizimin e investimit strategjik.

Masat mbështetëse që kanë një vlerësim pozitiv nga KIS janë si më poshtë vijon:

Masat e kërkuara	Rekomandimi	Institucioni përgjegjës	Procedura për masën e kërkuar e detajuar në faza. Detyrimet sipas institucioneve përgjegjëse	Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqesë subjekti	Afati	Kosto
Kryerje e procedurave me prioritet dhe brenda afateve të përshpejtuara, në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike;	PO	AIDA	Ligj 55/2015 i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim		Sipas legjislacionit të investimeve strategjike	

Vënie në dispozicion të plazhit/përdorim i brigjeve.	PO	AKB Bashkia Himarë	Kjo masë parashikohet në nenin 29 të Ligj Nr.55/2015, i ndryshuar. Masa ekzekutohet nëpërmjet marrëveshjes së investitorit me AKB, pas vënies në funksion të strukturës akomoduese turistike. Tarifa e kësaj marrëveshje përcaktohet me Vendim të Këshillit Bashkiak.	Verifikimet në terren, konfirmimi i planvendosjes sipas stacioneve të miratuara të plazhit për zonën në fjalë dhe tarifa e përdorimit konfirmohen nga AKB.	Sipas legjislacionit të investimeve strategjike.	
--	----	-----------------------	---	--	--	--

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

BLENDI GONXHJA

MINISTËR I FINANCAVE

PETRIT MALAJ

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

ANILA DENAJ

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS

LAURA PLAKU (SARO)